

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut dhe mos u përçani" (Ali-Imran 103)

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder
 Vitit I i botimit, Janar 2008 Nr 9. Çmimi 20 lekë.
 www.gazetabesimtari.com; e-mail: info@gazetabesimtari.com
 Kryeredaktor Selim Gokaj



KRYEPARLAMENTARJA TOPALLI I KERKON NDIHME TURQISE



Ditët e fundin bëri një vizitë në Turqi kryetarja e parlamentit shqiptar, z. Topalli. Në media u dha versioni se ishte një vizitë në kuadër të bashkëpunimit në mes të dy parlamenteve, por e vërteta është se vizita kishte të bënte me çështjen e Pavarësisë së Kosovës. Inkursioni i z. Topalli në shtetin turk tregoi se problemi i Kosovës nuk mund të zgjidhet jashtë kornizave që ka vënë diplomacia turke për këtë çështje, duke lënë të nënkuptohet se tashmë Turqia nuk do të bënte atë gabim që bëri gjatë luftës në Bosnje ,kur i la të zbuluar muslimanët e Bosnjes përballë armatës jugosllave që bëri ndaj boshnjakve masakra që do t,ua kishin zili edhe kriminelët më të regjur. Misionarja e maskuar e diplomancisë shqiptare zhvilloi bisedime me kryeparlamentarin e Turqisë ,z. Koxa Toptan, ku dy palët theksuan se mardhënjet në mes të dy palëve janë të shkëlqyera dhe se tashmë Turqia është një partner strategjik i Shqipërisë dhe më gjërë.Z. Topalli deklaroi se tek shteti turk shqiptarët, mbrenda Shqipërisë dhe jashtë

saj ,kanë gjetur tek shteti turk , tek qeveria turke dhe tek populli turk një mik të madh dhe të sinqertë që i është gjendur gjithmonë pranë në momentet më të vështira.Vizitat që pasuan më pas treguan misionin e vërtetë që kishte z.Topalli gjatë vizitës së saj, i cili tashmë nuk kishte të bënte më me punet e parlamentarve, por më problemin kryesor që sot i shqetëson të gjithë shqiptarët në hapësirat ku ato jetojnë.Ajo u prit në seanca tepër të veçanta nga figurat më të larta të politikës turke si.;Presidenti Abdulla Gyl dhe Kryeministri i suksesshëm, TaipRexhep Erdogan.Në këto sfera të larta të politikës turke u shtrua mbi tryezë mesazhi që solli nga qeveria shqiptare z. Topalli i cili i kërkonte qeverisë turke që të përdorte autoritetin e saj në Konferencën Islamike e cila, në takimin e saj të rrallës, të votonte në bllok një rezolutë ku zotohej që, në Këshillin e Sigurimit, vendet e Konferencës Islamike të votonin përsëri në bllok për Pavarësinë e Kosovës. Ishte krej normale premtimi dhe angazhimi i politikës turke në mbështetje të Pavarësisë së

Kosovës ,sepse tashmë është shumë e njohur se hapësirat ballkanike, ku rrallitet Bosnja ,Shqipëria dhe Kosova ,janë pjesë e planeve gjeostrategjike të politikës turke në Ballkan. Mediat turke i bënë jehonë të jashtzakonshme vizitës së Z.Topali në Turqi, duke treguar hapur dhe pa ekuivok se janë partner i sinqertë dhe i pa lëkundur i popullit shqiptar.Duket se kësaj rralle z.Topalli shikoi për here të pare miqtë e vërtetë të Shqipërisë dhe të shqiptarve dhe jo miq bishpërdredhur si Romano Prodi , Rumania , Spanja Greqia dhe shtete të tjerë të Evropës, ku duam të shkojmë ,që po i kundërvihen ,me politikën e tyre, Pavarësisë së Kosovës. Me të drejtë analisti Koço Danaj sulmoi politikën e sotme shqiptare duke deklaruar se lobingi më i forte proserb është pranë kufijve tonë i cili është në Itali dhe në Greqi me të cilët duhet të kemi vetëm mardhënje të fqinjësisë së mire dhe jo mardhënje stategjike. Vizitorja nga Shqipëria deklaroi se kjo vizitë është krej e veçantë nga të gjitha vizitat që kishte bërë. Ajo deklaroi se po e përsëris për here të dytë qe ishte pritja më e shkëlqyer që më është bërë. E vërteta është se respekti i veçantë që u tregua nga politikanët turq dhe mediat turke nuk kishin të bënin shumë me figurën personale të z. Topalli, por me respektin për popullin shqiptar respekti cili, në kurbën e tij ,nuk njih zbritje, pavarësisht rotacionit politik që, si kudo ,ndodh edhe në Shqipëri. Vizita e z. Topalli në Turqi ,e cila pasoi vizitën e kryeministrit Berisha në Egjipt ,ishin vizita që kërkonin mbështetje nga vendet e Konferencës Islamike për çështjen e Pavarësisë së Kosovës dhe janë pikërisht këto vizita, që na sjellin pranë vitin 1992, kur, ish- präsidenti Berisha e anëtarsoi Shqipërinë në Konferencën Islamike. Ngjarjet që vijuan më vonë dhe ato që po jetomë sot, treguan se inisiativa e Sali Berishës ishte shumë i drejtë sepse, në të gjithë përplasjet dhe vështirësitë e tranzicionit tone, përfshirë edhe vitin 1997, nuk ka gjurmë të asnjë nga shtetet e Konferencës Islamike. Shqiptarët kanë pasur dhe kanë një mbështetje të palëkundur nga Konferenca e Vendeve Islamike të cilën tashmë e ka pranuar edhe politika shqiptare, duke përjashtuar korbat e zinj dhe sorrat e zeza të politikës shqiptare që gjithmonë kanë çukitur në mbeturinat antishqiptare

Selim Gokaj
 Shkodër , me 26 dhjetor 2007

**SHPËRTHIM I SHOVINIZMIT
 RUSOMADH KUNDËR
 SHQIPTARËVE**

Fq 2

**VITI I RI NUK ESHTË
 FESTE ISLAME**

Fq 4

**DAJË SOROSI APO
 "SHOQËRIA CIVILE" LAKURIQ**

Fq 4

**SHTETI IZRAILIT
 ESHTË KUNDER
 PAVARESISE SE KOSOVES**

Fq 6

**NE PAKISTAN VRITET
 BENAZIR BUTO**

Fq 6

**INTELEKTUALI DHE
 SHOQËRIA NJERËZORE**

Fq 7



A do të tërhiqet SHBA para ultimatumit të Putinit për Kosovën

Në një konferencë për çështjet e sigurimit të mbajtur në Muni të Gjermanisë presidenti i Rusisë, Putin, ka bërë deklaratat më nervoze dhe ka paraqitur qëndrimet më antishqiptare që ka mbajtur Rusia deri tani për çështjen e Kosovës. Presidenti i sotëm i Rusisë është dukur edhe më i zemëruar dhe më kanosës ndaj SHBA për punën e Kosovës se paraardhësi i tij Boris Jelcin në një çast kur për bluf politik përmendi rrezikun e shpërthimit të luftës bërthamore në qoftë se nuk ndalet fushata e bombardimeve të NATO-s kundër Serbisë. Lidhur me qëndrimet e Rusisë për zgjidhjen e problemit të Kosovës sidomos lidhur me mundësinë e përdorimit të vetos ruse në Këshillin e Sigurimit për të bllokuar çdo vendim që nuk i pëlqente Serbisë janë bërë shpesh dhe plot vlerësime dhe hipoteza të kundërta. Nganjëherë theksohej se Rusia do të tregonte fleksibilitet, urti politike, pragmatizëm për të mos dëmtuar një veprim të përbashkët ndërkombëtar. Nganjëherë thuhej se Rusia do të përdorte veton për çdo projekt që nuk do të kishte miratimin e Serbisë. Disa analistë ishin më të prirur për të besuar në aftësitë e Rusisë për t'u përshtatur ndaj dëshirave dhe kërkesave të Perëndimit. Disa prireshin për të besuar më shumë kokëfortësinë e Rusisë ndaj Perëndimit duke mos lejuar pavarësimin e Kosovës dhe zgjatjen pa fund të marrjes së një mendimi ndërkombëtar me shpresë se do të ishin shqiptarët që do të lodheshin dhe do të praninin më në fund njëfarë sovraniteti të Serbisë mbi Kosovën. Paraqitja e planit të Ahtisarit dha si rezultat të parë konkret, ndonëse dëshpërues për shqiptarët dhe problematik për diplomacinë perëndimore. Rusia u

Shpërthim i shovinizmit rusomadh kundër shqiptarëve

nga Abdi Baleta

dha fund ngurrimeve dhe dredhive duke shpallur hapur qëndrimin e saj, që tashmë e kanë grushtuar së tepërmi sferën e hamendësimeve si për diplomatët e perëndimit ashtu edhe për analistët e vëzhguesit. Për më tepër, kësaj radhe është vetë presidenti i Rusisë që qartëson thelbin e qëndrimit rus duke mos lënë madje asnjë mundësi që instancat më të larta në politikën ruse të bëjnë ndonjë ndryshim nga ajo që u shpall.

Një Putin tejet i egërsuar deklarata e tij i lëshoi pikërisht në Gjermani, në territorin e vendit që ka kryesinë e BE-së dhe që dihet se ka një peshë të madhe politike e diplomatike në tërë proceset që lidhen me zgjidhjen e problemit të Kosovës. Zgjedhja e rastit dhe e vendit për të bërë deklarata të egra duket që ka qenë e llogaritur shumë mirë nga presidenti Putin dhe nga makineria gjigante politiko-diplomatike që ai komandon.

Presidenti rus e shumëzoi praktikisht me zero gjithë procesin diplomatik shumëvjeçar të diplomacisë ndërkombëtare për Kosovën sepse ai kërkoi që tani e tutje me këtë punë të merren vetëm Serbia dhe kosovarët. Me këtë manovër politike Putin e zhvlerëson tërësisht edhe efektin praktik të ndërhyrjes së NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999. Pra, me një deklaratë të thjeshtë për t'u kuptuar port ë bërë me tone shumë prepotente, presidenti rus i quan të kota gjithë ato që kanë ndodhur deri tani në Kosovë dhe lidhur me Kosovën në botë. Sipas tij: "Vetëm kosovarët dhe serbët mund ta zgjidhin këtë. Le të mos marrim rolin e Zotit dhe t'i lëmë ata të zgjidhin problemet e tyre". Me këtë në fakt Putin ka dalë kundër rolit të një Zoti të caktuar në Kosovë. Veçse ai do të zëvendësojë një Zot me një tjetër. ka dalë kundër rolit të një Zoti të caktuar në Kosovë. Veçse ai do të zëvendësojë një Zot me një tjetër, Zotin që mund të quhet diplomaci ndërkombëtare me një "Zot serb", më saktë me "Zotin pansllavist", sepse kuptohet që si gjithmonë pas "Zotit serb" do të qëndrojë ashtu si gjatë tre shekujve

të fundit "Zotit rus".

Kur përdor këtë "argument" zoti Putin shfaqet tërësisht si një politikan dhe diplomat i dështuar sepse argumenti i tij është pa argument dhe primitive. Se çfarë do të thotë "Zot serb" për Kosovën, shqiptarët e dinë mirë me kohë, e dinë nga një histori e gjatë qysh kur serbët u shfaqën në Ballkan nga kënetat ruse. E dinë edhe më mirë nga koha moderne kur kanë qenë nën thundrën pushtuese të Serbisë e Jugosllavisë monarkiste, Jugosllavisë komunisto-titisterankoviçiane, Serbisë nacionalshoviniste millosheviçiane.

Zoti presidenti i Rusisë nuk dashka që në Kosovë të ketë zgjidhje të imponuar. Kur BS me aleatët e mposhtën Gjermaninë e Hitlerit, e detyruan atë të kapitullojë pa kushte. Mos vallë kjo ishte një zgjidhje e imponuar dhe e gabuar?! Duket që presidenti rus për zgjidhje të pranueshme për të dhe për serbët quan vetëm zgjidhje si ajo që ai i ka dhënë problemit të Çeçenisë, zgjidhjen e rrënimit të qyteteve dhe të fshatrave, të vrasjeve masive dhe të vënies së një udhëheqësi kukull. Pra, Putin në Gjermani nuk ka kërkuar gjë tjetër veçse t'i lihet dorë e lirë Serbisë në Kosovë të bëjë siç ka bërë Rusia e Putinit në Çeçeni.

Kur Putini klith: "Le të mos marrim rolin e Zotit" ai në fakt do të thotë le të mos bëjmë drejtësi ndërkombëtare, le t'i njohim Serbisë mundësinë të jetë vetë Zot e vet shkop në Kosovë, të bëjë vetëgjyqësi ndërkombëtare si në kohën e Millosheviçit, deri atëherë kur shqiptarët vetë të mendohen mirë e të nënshtrohen për të pasur një trajtim më të butë. Një tjetër argument i dështuar dhe primitiv dhe jo serioz për presidentin e Rusisë në shekullin XXI. Edhe carët e hershëm autokratë nuk do të flisnin me prepotencë të tillë në fund të betejave që kishin fituar me kundërshtarët. Putin i ka përsëritur edhe njëherë ato pseudoargumentet e bëra bozë se pavarësia e Kosovës do të nxisë një reaksion zinxhir si në zbërthimin e atomit, një proces të

pafund kërkesash e përpjekjesh për pavarësi në vende të tjera. Këto pseudoargumente qesharake janë hedhur poshtë plotësisht tashmë. Duket që Putini i ka përsëritur për inerci dhe me shpresë se mos gjen mbështetje nga ndonjë spanjoll që i pëlqen për hallet e veta. Po pse të mos i thuhet çiltër fare e thjesht presidentit rus: ç'të keqe ka në rast se pas Kosovës edhe popuj të tjerë mund të kërkojnë pavarësi nëse i kanë kushtet dhe vullnetin politik përkatës? Pse pavarësia qenka e lejueshme për disa dhe e ndaluar për disa të tjerë? Ç'e keqe i ka ardhur botës se pas Luftës së Dytë Botërore është katërfishuar numri i shteteve anëtare të OKB-së. Ç'të keqe i ka ardhur botës se vetëm nga shpërbërja e tri federatave sllave në Europë, BS, Jugosllavisë dhe Çekosllovakisë gjatë 10-15 vjetëve të fundit kanë dalë plot 20 shtete të reja? Pse vetëm për Kosovën u bëka kiameti po të fitojë atë që e kanë dhe të tjerët dhe që e meriton më shumë se të tjerët? Presidenti rus i përdor pseudoargumentet e tij sepse do t'i krehin bishtit si gjithmonë qenit roje të Rosisë në Ballkan, Serbisë dhe se nuk duron dot që edhe shqiptarët pak nga pak të fitojnë ato të drejta që ua ka mohuar me arrogancë Rusia gjatë 150 vjetëve qysh kur nisi çështja kombëtare shqiptare. Putini ka përdorur një argument që ngjan si i ri: "Nëse njëri nga pjesëmarrësit në këtë problem do të mbetet i lënduar kjo gjë do të zvarritet për shekuj". Këtu nuk është puna do të mbetet apo jo e lënduar njëra palë në konflikt, por është puna se kush ka të drejtë, kujt i është shkelur e drejta, kush duhet rivendosur në të drejtën e tij edhe nëse nga vënia në vend e drejtësisë lëndohen marrëzitë e dikujt. Por sipas Putinit rëndësi ka të mos lëndohen serbët dhe të lëndohen shqiptarët sepse Putini mendon se serbët janë kombi shenjtëruar në Ballkan dhe mund të mbakan nën robëri të tjerët. Kështu e kupton z. Putin rolin e zotit që duhet të jetë sllav. Konflikti shqiptaroserb në Kosovë vazhdon prej shekujsh dhe të keqtrajtuarit janë shqiptarët. Nëse shqiptarët nuk i fitojnë të drejtat e tyre edhe sikur punët të bëhen sipas urdhrave të "Zotit sllav" konflikti përsëri do të vazhdojë. Zoti Putin nuk ka dhënë asnjë formulë magjike për përjashtimin e konfliktit në zonën e Ballkanit. Zoti Putin iu vërsul egërsisht edhe Amerikës duke e akuzuar atë sikur është djalli vetë me atë mbështetje që i jep shqiptarëve

në Kosovë për t'i prishur punën "zotit sllav". Me një mllef të pabesueshëm për t'u derdhur nga një kryetar shteti në një veprimtari diplomatike, zoti Putin kërkoi hiç më pak se një përmbysje rrënjësore të rolit dhe të pozitës së SHBA në botën e sotme, që realisht u bë një polare pas shembjes së BS. Ai duket se nuk mund të durojë më këtë botë njëpolare ku vendimet kryesore natyrisht po i merr SHBA. Ai kërkon përsëri një botë të ndarë në dy pole si në kohën e Luftës së Ftohtë. Është e drejta e tij të kërkojë ç'i pëlqen dhe ç'i duket e mirë për Rosisë, por kjo nuk përbën ndonjë të drejtë detyruese për të tjerët. Putini më në fund shpalli pretendimin rus që Rusia të rimarrë në arenën ndërkombëtare sërish rolin e BS komunist. Ky duket është shqetësimi kryesor dhe ambicia e Putinit në mbarim të mandatit të tij dhe në fillim ndoshta të epokës pas Putin në Rusi. Pas gjithë atyre deklaratave që u lëshuan nga Putini (aq sa janë transmetuar nga mjetet e informimit) lind një pyetje enigmë: Cili është synimi kryesor i presidentit rus (i) të shfrytëzojë çështjen e Kosovës për një strategji politike më të gjerë, për t'u vërsulur kundër politikës amerikane, apo (ii) e bën këtë sulm të egër edhe ndaj Amerikës sepse parësore ka të realizojë synimin e tij më të ngushtë të mbajë Kosovën nën Serbi dhe mendon se këtë mund ta realizojë duke trembur SHBA me akuza e kërcënime ultimative për prishjen e ekuilibrit ndërkombëtar. Është e qartë se Putini i ka pasur dhe i ka të dyja këto ambicie dhe objektiva, por më e saktë dhe më e arsyeshme është të mendohet se qëllimi kryesor dhe parësor i Putinit ka qenë të ngrihet kundër pozitës dhe rolit të SHBA në botë, për një përmbysje të atij ekuilibri ndërkombëtar që pas shpërbërjes së BS u quajt rend i ri botëror nga ish-presidenti amerikan Bush, babai i presidentit të sotëm Bush. Atëherë Rusia e ndjeu veten të mos përfillur, por ishte dobësuar dhe nuk kishte si reagonte më fort. Tani duket sikur e ka marrë disi veten dhe mund të tregojë përsëri dhëmbët dhe të shtrijë kthetrat. Putini shpalli se Kosova i duhet lënë Serbisë që ta ndreqë, kurse SHBA duhet të merret me pretendimet ruse për një hegjemonizëm të ri dypalësh. Putini e stigmatizoi ashpër SHBA se nuk është aq demokratike sa hiqet, se nuk është ajo që duhet t'u mësojë demokracinë vendeve të tjera. Sado të qortueshme të jenë disa

aspekte të politikës amerikane sot lidhur me eksportimin e dhunshëm të demokracisë nëpër botë, përsëri SHBA mbetet bastion i demokracisë, mbetet mësues i mirë i demokracisë për Putinin dhe Rosisë e tij dhe jo e anasjelltas. Pas fjalimit të Putinit u vërtetua edhe më mirë vlerësimi i atyre analistëve që ishin shprehur me kohë se çështja e Kosovës kishte ngecur keq në rrjetat e rivaliteteve amerikanoruse. Tani shtohet dhe një element tjetër rreziku për shqiptarët, Putini dhe Rusia po i kërkojnë në formë ultimative Amerikës që një proces i ri "ulje tensioni" (detante) si dikur në kohën e Hrushovit duhet të nisë midis SHBA e Rosisë dhe për këtë duhet bërë një kurban në Ballkan, duhen bërë kurban të drejtat e Kosovës dhe të shqiptarëve, që të rritet disi prestigji i Rosisë me mbrojtjen e lakmive të Serbisë. A do të trembet vallë Amerika para ultimatumit të Putinit dhe të bëjë lëshime të kësaj natyre? Mos e pastë dhënë Zoti. Deklarimet e para të senatorëve amerikanë për fjalimin e Putinit në Gjermani ishin një përgjigje serioze e dinjitoze dhe përmbanin paralajmërime të qeta, por të forta për pasojat e yryshit që ka marrë Putini për të kthyer botën në kohën e Luftës së Ftohtë. Putini në Gjermani shantazhin që kishte bërë ndaj Europës me ndërprerjen e furnizimeve me naftë e gaz (që tani kuptohet që ka qenë një lojë e ndyrë që e kurdisi me diktatorin e Bjellorusisë) e ka dyzuar me një shantazh tjetër politik, diplomatik dhe ideologjik kundër SHBA. Kështu e ka hapur këtë lojë të madhe e të rrezikshme duke menduar ndoshta se shantazhi me naftën dhe gazin ka patur njëfarë ndikimi në Europë dhe kjo Europë do të jetë më neutrale se herë të tjera në ballafaqimin ruso-amerikan. Kosova dhe shqiptarët mund ta paguajnë me pësime të reja nga sherret e reja amerikano-ruse që vijnë bash në momentin më delikat për çështjen e Kosovës. Por asnjëherë nuk i dihet. Ndoshta nga ky sherr i ri mund të shkojnë më shpejt disa procese të hequra zvarrë, mund të lëvizin nga vendi zgjidhje që deri tani i kishte gozhuar politika ruse me taktika klasike të saj për zvarritjet diplomatike. Me hajër daltë përplasja diplomatike që ka nisur Putini.

VITI I RI NUK ESHTE FESTE ISLAME



Sapo ka kaluar festa e Vitit të Ri dhe na duket se veshët vazhdojnë të na tronditen nga zhurma e fishekzjarreve dhe e rrëmujës shumplanëshe të cilën e përjetuam në emër të një feste që na thuhet se festohet në të gjithë botën, në një kohë që festohet e motivuar vetëm në vendet e krishterë, alias katolikë dhe ortodoksë. E verteta është se festa e Vitit të Ri përfaqëson ndjenjat dhe motive të krishtera, sepse vetë ai, që ne e quajmë babagjyshi i Vitit të Ri, është babagjyshi i Krishtlindjeve dhe është sajuar nga kisha që të largojë

paganizmin nga ndjenjat e njëzve . Në një bisedë fetare, në xhaminë Ebu Beker, myftiu i Shkodrës, Imam Ndrim Sulejmani, u kujtoi besimtarëve se pema e Vitit të Ri është pema e Krishtlindjeve dhe se ai që quhet Santa Klaus dhe që ndan dhurata, është Shën Nikolla.

Festa e Vitit të Ri ka të bëjë me traditën dhe kulturën e krishterë dhe nuk ka asnjë element të fesë islame e cili do t'i obligonte muslimanët që ta festonin këtë festë. Prandaj, nuk është e lejuar për një musliman të festojë festa që nuk janë të tijat, por të një feje tjetër. Ne i respektojmë të gjitha fetë, por secila nga fetë ka parime që janë të pranueshme për besimtarët e saj. Në këtë linjë duhet arsyetuar kur ne, si muslimanë, jemi kundër festimet të festës së Vitit të Ri nga muslimanët, aq më tepër kur Profeti, Muhamedi a.s. na porosit që, kur një popull i ngjan një populli tjetër, ai është si ata. Muslimani e ka rreptësisht të ndaluar që të festojë festa, të cilat prekin moralin islam, festa ku pihet alkooli, ku merret drogë, ku degjenerohet rinia përmes kërcimeve të shthurura. Festimi i festës së Vitit të Ri nën një etiketë të rreme "Qe duhet festuar se ndërrohen vitet" është një reklamë e sheqerosur që muslimanin e largon nga feja e vet, në një kohë që ne, si muslimanë, Allahu xh.sh. na ka bërë dhuratë festat tona madhështore si: Fitër Bajramin, Kurban Bajramin dhe shumë festa të tjera që janë pjesë e kalendarit islam.

Allahu xh.sh. i do dhe i mëshiron ata që ecin në rrugën e tij. Muslimanët duhet ta dine se shpëtimi i vërtetë për ata është kur ata jetojnë me fenë e Allahut xh.sh. dhe nuk shmangen nga feja e tij. Por, për fat të keq, muslimanët sot nuk po e kuptojnë identitetin e tyre të vërtetë dhe po bien pr e atyre që po bëjnë të pamundurën që t,ua

shkatërrojnë këtë identitet, duke angazhuar media, politikë, armë dhe festa për të realizuar daljen e muslimanëve nga identiteti i tyre. E vërteta është se shumë muslimanë janë përfshirë pa rezerva në festimin e Vitit të Ri, duke u krijuar kushte fëmijve të tyre dhe të rinjve në familjet e veta, që ta festojnë me shumë bujë këtë festë që nuk është në asnjë parameter festë e muslimanëve. Rreziku i festimit të kësaj feste në familjet muslimane është se po e kthejnë vetë muslimanët në traditë të tyre dhe në festë të tyre. Kuptimplotë për të arsyetuar në këtë linjë është mënyra si u festua Viti i Ri në hapësirat shqiptare, mrenda dhe jashtë Shqipërisë Londineze. Pasi u kalua thujse në heshtje nga mediat festa e Kurban Bajramit, ata shpërthyen, kur erdhi dita e Krishtlindjeve dhe Viti i Ri, duke mbushur ekrane me kumbona, me babagjyshë, të mëdhej dhe të vegjël, me pemë Krishtlindjesh që konkuruan kësaj radhe për "Mis Pema e Krishtlindjeve", veprime që u pasua edhe në politikë, kur Valentina Leskaj dhe politikanë të tjerë mashtruan duke deklaruar se Krishtlindjet i festojnë të gjithë shqiptarët, thujse bëhej fjalë për një popull të krishterë. Kurse presidenti Topi, me familjen e vet, ndanë dhuratat e Vitit të Ri për jetimët, dhurata që mund të ishin dhënë edhe në ditën e Kurban Bajramit. Në mediat shqiptare nuk munguan filmat fetarë për Krishtlindjet, në një kohë që nuk u pane, si zakonisht, flma dhe emisione për festën e Kurban Bajramit. Mediat arritën deri aty sa në ditën e Kurban Bajramit dhanë emision për Krishtlindjen. Muslimanët nuk janë xhelozë, as nuk shqetësohen nga madhështia e festave të religjoneve të tjera. E vetmja gjë, për të cilën janë të shqetësuar muslimanët, është se ato nuk janë dakort për asnjë lloj diversioni që mund të behet nga politika ose segmente të tjera kundër fesë islame. Harmoni fetare do të thotë respektimi me parametra të barabartë i të gjitha feve dhe respektimi i parimeve të tyre me standarte të barabarta. Vetë atëherë deklaratat se "Në Shqipëri ka një tolerance ideale në mes të të gjitha feve" do të tingëllojnë si të vërteta.

Dajë Sorosi apo "shoqëria civile" lakuriq

Olsi Jazexhi

Fitorja e Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore këtë shkurt 2007 në Shqipëri, erdhi pa ndonjë problem të madh, pasi agresioni propagandistik me të cilin shoqëria shqiptare është përballur në këta muajt e fundit nga e ashtuquajtura 'shoqëri civile' që kishte marrë si mision shkatërrimin e pozitës dhe sjelljen në pushtet të Edi Ramës; do të jepte rezultatet e pritura. Kërcënimi që Soros i bëri Berishës publikisht nëpërmjet ekranit të Top Channelit pas zgjedhjeve të vitit 2005, për të mos prekur me dorë Ramën si Putini Khodorkovskin, bindi të madh e të vogël në Shqipëri se dajë Sorosi kishte rënë në dashuri me Edvinin, dhe se Berisha nuk mund të godiste krimin si Putini. Nën hyqmin e ambasadës amerikane dhe Sorosit, të gjithë rrogëtarët e dy të parëve që nga: Mjafti, MAPO, Aksioni Civil dhe Erion Veliaj, Gent Ibrahim, Çapajev Gjokutaj, Andrea Stefani, Ardian Klosi, Mustafa Nano, Skënder Minxhozi etj bënë atë që tashmë njihet, korin e 'shoqërisë civile' i cili sa herë që mafjes Rama i preket ndonjë interes personal fillon e qurravitit rrugëve si kuçkë. Janë të njëjtat fytyra që protestojnë rrugëve kur qeveria Nano psh. I heq Edi Ramës dhe Koço Kokëdhimës monopolin mbi plerat e Tiranës, ata që protestojnë edhe sot për mbajtjen e njeri tjetrit në pushtet. Megjithatë kësaj radhe bukëngrënësit e Sorosit në Tiranë, kërkonin ndër të tjera me çdo kusht plotësimin e axhendës që bukëdhënësi i tyre ju kishte caktuar dy vite më parë, sjelljen në karrike të Edi Ramës. Maskarada shoqëri civile që po ndodh sot në Shqipëri është një fenomen që në vitet e fundit po ndodh në një mori shtetesh të botës së tretë. E ashtuquajtura 'shoqëri civile' e cila punon për ambasadat perëndimore, sot kërcënon gjithnjë e më tepër stabilitetin dhe demokracinë vendeve të botës së tretë. Të trembura nga agresioni i huaj nëpërmjet OJQ-ve, në Rusi, Zimbabve dhe Eritrea qeveritë kanë ndërtoar masa ligjore që të mbrohen nga "Instituti i Shoqërisë së Hapur - Soros" dhe tentakulat e saj. Ndërsa një seri vendesh të Evropës Lindore kanë mbyllur organizatat sorosiane, të cilat duke nisur që nga Polonia, Hungaria, Gjeorgjia, Ukraina, Jugosllavia, por edhe Shqipëria, kanë rëzuar qeveri dhe zhytur vendet në luftë. Ndërsa në Venezuelë qeveria ka akuzuar disa prej kërreëve të organizatave të 'shoqërisë civile' sorosiste për tradhëti dhe burgosur, në Irak dhe Afganistan luftëtarët e lirisë, vrasin herë pas here 'shoqëri civilasit' e OJQ-ve perëndimore. 'Shoqëria Civile' të cilën Joan Roelofs në Revistën CounterPunch të majit 2006 do ta quante si shërbëtore të imperializmit, në ditët tona ka zëvendësuar punën që misionarët e krishterë bënin shekuj më parë për njeriun e bardhë. Në rastin e Shqipërisë e ashtuquajtura shoqëri civile' është kthyer në një prostitutë intelektuale që në shërbimin të parasë së vëllait amerikan, që nga viti 1991 e deri më sot, është bërë pjesë e shkatërrimit kulturor dhe politik të vendit. Tragjikomedia që po i ndodh sot Shqipërisë ku Soros, ambasada amerikane, hollandeze etj me një seri OJQshë të pompura nga ato, vendosin axhendën e shoqërisë, shkatërrojnë vendin me 'terapi shok', imponojnë për kryetar Bashkie të Tiranës një hajdut dhe degjeneratë, janë pjesë e politikës së hapur kolonialiste që perëndimi me në krye SHBA-të po ndjekin me të gjitha vendet e botës së tretë që pas rënies së bllokut komunist. Hajduti i toqeve ndërkombëtare Xhorxh Soros dhe OJQ-të përreth tij, nën justifikimin e ndihmës humanitare, kanë arritur që të rekrutojnë në shoqëritë e botës së tretë mercenarë të bindur, të cilët ndjekin verbërisht politikën e vëllait të madh i cili zhyt vendet e varfëra në borxhe dhe në varësi ekonomike skllavëruese, dhe imponon ardhjen në pushtet të personave të korruptuar. Ajo që Soros dhe amerikanët bënë në Shqipëri në këto zgjedhje të fundit, ku pothuaj 90% e shoqërisë civile, medieve dhe grupeve të presionit lehnin kundër qeverisë dhe mbronin bythët e ekspozuara të Edi Ramës në publik, gjen precedentin e



saj më original në Gjeorgjinë e vitit 2003 kur amerikanët në bashkëpunim me Sorosin larguan nga pushteti president Shevernazen. Si në rastin e Shqipërisë edhe në Gjeorgji amerikanët me Sorosin mbështetën organizatën KMARA (Mjaft) e cila sëbashku me netuorkun e Sorosit në Evropën Lindore organizuan të ashtuquajturin revolucion velvet. Mark Mackinon e shpjegon kështu mënyrën sesi Soros organizoi grushtin e shtetit në Gjeorgji në një shkrim të botuar në gazetën kanadeze 'Globe and Mail': "Në muajin shkurt 2003, milioneri Xhorxh Soros filloi përpjekjet e rrëzimit të Presidentit të Gjeorgjisë, Eduard Shevernaze. Gjatë këtij muaji, Instituti i tij 'Për një Shoqëri të Hapur' Soros, dërgoi nga Tbilisi aktivistin Giga Bokeria për në Serbi për t'u takuar me anëtarët e Otpor-it dhe mësuar si u organizuan demonstratat për të rrëzuar Slobodanin. Më pas, në verë 'Fondacioni Soros' pagoi biletat e aktivistëve të Otporit të cilët për tre ditë me radhë zhvilluan kurse trajnimi mbi mënyrën sesi të përshkallëzonin një revolucion paqësor të më tepër se 1000 studentëve. Javën e fundit, 'Instituti i Lirisë' në të cilin Bokeria u ndihmua, ishte edhe instrumenti organizativ i protestave të rrugës, të cilat sollën edhe dorëheqjen e Shevernazes. Bokeria, thotë se në Beograd mësoi vlerën e mbajtjes lartë të moralit dhe si të bënte të vlefshëm presionin publik, taktika që çuan në rrëzimin e qeverisë. Përve kësaj Soros sponsorizoi edhe një televizion opozitar shumë popullor i cili ishte pika kyçe e mbështetjes së "revolucionit velvet," ndërsa në anën tjetër pagoi një grup të rinjsh që të protestonin në rrugë kundër qeverisë." Në rrëzimin e Shevernazes përveç 'Shoqërisë së Hapur' të Sorosit financuan edhe Instituti 'Eurasia' i përkrahur nga qeveria amerikane dhe tre organizata të tjera që ishin Partia 'Lëvizja Kombëtare' e Mikhaël Sakashvilit, Televizioni Rustavi-2 dhe Kmara apo MJAFTI gjeorgjian, të cilët deklaruan luftë mbi qeverinë patriotike të Shevernazes. Rasti i Gjeorgjisë më lartë është pothuajse identik me atë që ndodhi kundër Partisë Demokratike në zgjedhjet e fundit. Kundër pozitës në Shqipëri, Sorosi arriti të mobilizojë Mjaftin, një seri televizionesh dhe gazetash që nga Vizion +, Top Channel, Gazeta Shqip, Shekulli etj, një grup të madh OJQ-shë, Partinë Socialiste dhe satelitët e saj në të gjithë vendin. I përballur me këtë fushatë të egër propagandistike jo PD-ja por çdo Parti që është në pushtet në Shqipëri nuk mund të përballojë dot mbijetesën. Mbi strategjinë e agresionit publik për të rrëzuar qeveritë në këtë formë, Mark Mackinon citon Sorosin i cili mburret duke thënë se "është e nevojshme të mobilizojmë shoqërinë civile në këtë mënyrë për të siguruar zgjedhje të drejta"... "pasi kjo është ajo që ne bëjmë në Sllovaki në kohën e [Vladimir] Meciarit, në Kroaci në kohën e [Franjo] Tuxhmanit dhe në Jugosllavi në kohën e Millosheviçit." Në shkrimin

'NED-i, OJQ-të dhe Përdorimi Imperial i Filantropisë' të cituar më lartë Joan Roelofs vëren se OJQ-të që në ditët tona sjellin dhe rrëzojnë qeveritë si në rastin më të fundëm Rama Berisha, janë shërbëtorë të konglomeratëve perëndimorë, të cilët nëpërmjet agjentëve të tyre shtrinë pushtetin në të gjithë vendet e botës së tretë. Këto OJQ financohen nga organizata perëndimore që nga American Express Foundation, Bristol-Myers Squibb Foundation, Carnegie Corporation, Canadian International Development Agency, Ford Foundation, Harvard University, Oxfam dhe UNDP-ja (United Nations Development Programme). Të njëjtët emra dikush mund të lexojë edhe kur hyn në sajtin mjaft.org, ku Mjafti që supozohet 'të sjellë demokraci' në Shqipëri falenderon bukëdhënësit e saj që janë Këshilli i Evropës, OSBE, Fondacioni Rockefeller, Fondacioni Ballkanik për Demokraci, Soros, UNDP dhe ambasadat hollandeze, britanike, amerikane, gjermane, zvicerane dhe norvegjeze. Sipas Joan Roelofsit, puna që OJQ-të e tipit MJAFT paguhen të bëjnë zakonisht, është që të flasin dhe dalin në mbrojtje të: "demokratizimit", të drejtave të njeriut, decentralizimit, mbrojtjes e pederastëve, hajdutëve me pushtet, apo të mbrojnë politikën pushtuese dhe hegjemoniste amerikane nëpër botë, apo edhe organizimin e koncerteve të rokut apo nxjerrjes së huliganëve në rrugë. Karakteri i tyre mercenar në pothuajse asnjë rast nuk i çon këto OJQ që të merren me aksione bamirëse si ndihma ndaj të varfërve, ndërtimit të klinikave, spitaleve dhe shërbimeve të tjera humanitare. Qëllimi i OJQ-ve të sponsorizuara nga filantropitë perëndimore në shumicën e rasteve synon ose që të rrëzojë apo terrorizojë qeveritë e papabindura ndaj hegjemonisë amerikane dhe filantropëve multimiliarderë, ose të mbrojnë dhe justifikojnë në publik grupet që favorizohen nga donatorët e tyre. Aktivitetet e shoqatave si Mjafti në Shqipëri, Forumi Qytetar në Ceki, Solidarnosi në Poloni, Bashkimi i Forcave Demokratike në Bullgari, Otpori në Serbi dhe Kmara në Gjeorgji kanë dëshmuar në vazhdimësi që kanë prodhuar vetëm kaos, dhunë dhe degjenerim. Sponsorët kryesorë të këtyre organizatash, përveç ambasadës hollandeze, Bankës Botërore, FMN-së dhe ambasadës amerikane që pompojnë MJAFTI-n e Erion Velisë me para, janë edhe NED-i apo Ndihma Amerikane për Demokraci që është pjesë e CIA-s, fondacioni Rockefeller, Ford dhe Soros. Edhe pse sipas Statusit të OKB-së të konspirosh për të rrëzuar qeveritë e vendeve sovraane është ilegale, që pas rënies së bllokut komunist, amerikanët nuk respektojnë më ligje ndërkombëtare. Misionet e tyre diplomatike nëpër botë janë kthyer në kampe gjysmë ushtarake dhe etja e tyre për pushtet i ka kthyer në xhandarë që sillen si guvernatorët kolonialë njëherë e një kohë. Për lexuesit e vëmendshëm të historisë, sjellja e Sorosit dhe

ambasadës amerikane sot në Tiranë i ngjan sjelljes së NED-it dhe amerikaneve në Nikaragua të fundviteve 1980. Nga që amerikanët në atë kohë ishin të vendosur të shkatërrojnë në çdo mënyrë revolucionin sandinist dhe zgjedhjet e lira që Daniel Ortega fitoi me 63% të votave, ambasada amerikane dhe administrata Regan i bënte presion opozitës që të mos merrte pjesë në zgjedhje, ndërsa mbështeste 'rezitencën demokratike' të kontrastve. Të njëjtin presion për mospjesëmarrje në zgjedhje ne pamë që bëri edhe opozita socialiste dhe OJQ-të rreth saj në këto zgjedhje 2007, dhe thirrjet që ajo po bën këto ditë për zgjedhje të parakohshme. Politika destabilizuese e OJQ-ve të 'shoqërisë civile' sot shihet edhe në Venezuelë ku nëpërmjet fondeve masive të NED-it dhe Sorosit, amerikanët kërkojnë të shkatërrojnë qeverinë demokratike të Shavezit, duke krijuar OJQ si 'libraritë e pavarura', 'gratë e kuqe kubaneze' etj që ngajnë shumë me OJQ-të e Tiranës si Klubi 2000, Mjaft, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit etj. Përveç përmbysjes së regjimeve demokratike, OJQ-të që perëndimi mban me bukë nëpër vendet e botës së tretë, kur nevoja lind, vihen në punë edhe për të ndaluar projekte popullore dhe reformiste që bien ndesh me interesat e qarqeve neo-liberale dhe kërcënojnë pushtetin e tyre. Një rast i këtillë u pa në Tiranë psh. në vitin 2003 kur fondemarrësit e Sorosit dhe NED-it me klubin e tyre "Klubi 2000" me Sabri Godon, Genc Rulin, Pirro Mishën dhe Mustafa Nanon në krye kundërshtuan ngritjen e xhamisë në Namazgjanë e Tiranës pasi kështu "prishej hapësira e gjelbërt e qytetit dhe dëmtohej interesi publik". Siç Abdi Baleta kujtonte në këtë kohë në shkrimin 'Të mos komercializohen vlerat Shpirtërore myslimane' këta zotërinjë nuk kundërshtuan katedralen katolike kur ajo u ngul në një park pak metra larg Namazgjasë, që i përkiste mbretit Zog. Klubi 2000 nuk protestoi as kur Cac Angjeli ktheu në shesh ndërtimi Namazgjanë e Elbasanit. Dhe normalisht nuk u ndje edhe kur Edi Rama disa muaj më vonë do ti jepte leje Janollatosit që të merrte një lulishte shtetërore dhe ta bënte Katedralen Ortodokse. Heshnja e "Klubit 2000" kuptohet duke lexuar shqetësimet që spiunazhet perëndimore kanë sot në Shqipëri; dhe në këtë rast me islamin i cili është religjioni më i pabindur ndaj diktatit të hegjemonëve botërorë. Në fushën e lojës më shoqërinë civile dhe luftën kundër traditave dhe fesë në kohët e fundit shihet që nuk ka ndejtur pas as NATO, e cila me vendet satelite të Evropës Lindore, sot silltet me keq sesa administrata e Traktatit të Varshavës në kohën e Bashkimit Sovjetik. Pasi ka shkatërruar ushtritë e vendeve Ballkanike dhe në veçanti atë shqiptare, dhe ka hedhur një gjeneratë të tërë ushtarakësh në rrugë, NATO jep një seri grantesh për të mbajtur urtë ushtarakët më me influencë dhe vazhduar shkatërimin e mëvetësisë së ushtrive evropjano lindore. Një zhvillim interesant nga NATO është edhe sponsorizimi që ajo i bën OJQ-ve të 'shoqërisë civile' si psh 'Millenium Club Center' të Rexhep Mejdanit e cila në shtator 2006, sulmoi përkatësinë islame të shqiptarëve duke i nxjerrë ata në 35.4% muslimanë. Siç Joan Roelofs kujton në shkrimin e sipërcituar, çfarë perëndimi synon me sponsorizimin e OJQ-ve kërpudha në botën e tretë sot, është të ndërtojë organizata vasale, të cilat do të lehin vetëm për dorën që i ushqen ato. Apo siç Thomas Carothers, drejtues i Carnegie Endowment shkruan: "Shoqëria civile transnacionale është... pjesë e projektimit të fuqisë politike dhe ekonomike perëndimore, ku anëtarët e saj duhet të bëjnë për ne, atë që në kërkojmë në vendet e tyre." Politikën që OJQ-të perëndimore ndjekin sot me shqiptarët dhe popujt e botës së tretë janë kolonizuese në aspektin mental dhe material. Misioni i tyre është shkatërrimi i shoqërisë së vërtetë dhe të pavarur civile dhe ndërtimi i intelektualë yzmetqarë që punojnë për bukëdhënësit e tyre perëndimorë. Siç edhe rasti i USAID-it tregon në Shqipëri, këto organizata nxisin projekte që shpesh synojnë zhdukjen e popullatave, traditave dhe kulturës së popujve të botës së tretë. Kështu shqiptarët janë mësuar tashmë që nga vitet 90 të shohin në televizorë reklamën e sponsorizuara nga USAID për planifikimin familjar të cilat USAID-i i mburr në faqen e saj të internetit, ndërsa tregon sesi amerikanët kanë mësuar 'zulutë' shqiptarë sesi të përdorin këllëfë turpi. Ndërsa sot në perëndim, qeveritë këllëfë turpi. Ndërsa sot në perëndim, qeveritë gjermane, amerikane, britanike etj nxisin ritjen e popullsisë duke i motivuar familjet me ndihma ekonomike, në rastin e Shqipërisë ku rritja demografike e shqiptarëve është faktori i vetëm që ka siguruar mbijetesën tonë kundër hegjemonisë serbo greke, sponsorizohet zhdukja e avashtë e popullsisë nëpërmjet planifikimit familjar. Një tjetër kusht që OJQ-të e vëllait të madh i vënë në ditët tona fondemarrësve të tyre është

edhe mbështetja publike që ata duhet ti bëjnë politikës së jashtme amerikane. Jo më kot përpara luftës në Irak, por edhe më pas, të gjithë fondemarrësit e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, me të cilët më ka rënë shpesh të kundërshtohem në programe televizive, tregoheshin më katolikë se Papa kur vinte puna te justifikimi i agresionit amerikan nëpër botë. Korrupsioni i shoqërisë civile shqiptare sot nga donatorët perëndimorë ka marrë përmasa katastrofale. Përpara 2 vitesh një punonjës i lartë i USAID-it mua më mburrej me ushtrinë me mercenarë të bindur dhe servilë që amerikanët kanë ndërtuar në Shqipëri, të cilët sipas tij përbënin 90% të OJQ-ve në vend. Ndërsa një zyrtar gjerman, kur e akuzoja që me Mjaftin dhe Edi Ramën perëndimi po imponon një neo-imperializëm politik në Shqipëri, më justifikojë se perëndimi nuk kishte opsion tjetër me Ballkanin perëndimor, por të impononte kukullat e tij. Servilizmi dhe korrupsioni i shoqërisë civile shqiptare sot, ka marrë përmasa alarmante siç u pa fare qartë këtë shkurt 2007, kur qytetit të Tiranës ju imponua sërisht për kryebashkiak një rrugaç dhe vagabond, të cilin Sorosi dhe OJQ-të e tij langaraqe i bënë hoshana. Moskundërshtimi i maskaradës së Ramës por mbështetja e tij nga klientët e 'shoqërisë civile' sorosiane e kanë kthyer shoqërinë tonë në të njëjtat pozita me atë të viteve 80, kur të gjithë shqiptarët edhe pse e shihnin Enver Hoxhën psikopat, i bënë sërish hoshana. Duke u përballur më këtë tragjedi kombëtare ku axhenda politike e vendit po merret peng nga sorosistët dhe Edi Ramët që na bëjnë karshillëk me hallatet jashtë, patriotët shqiptarë duhet të marrin iniciativën dhe të sillen me OJQ-të soriste sipas shembullit rus, ukrainas dhe venezueljan; apo nëpërmjet refuzimit publik të kësaj maskarade mediatike... pasi perandori tashmë ka dalë pa rroba, dhe populli nuk ja ka për borxh të durojë ekspozenë e tij të pështirë.

HARUN AL-RASHID DHE KARLI I MADH

*Kur Al-Rashid Islamit përçonte Karli me shpat Evropën kryqzonte.
Kur shatrivanët e Harunit ndrisnin pallatin Karlit uji s,ia preku kurrë shtatin.
Kur me unë zjarri Karli natën kalonte Drita e kandilave Kalifatin ndriçonte.
Karlin e Evropës e bani m,u bind Bukurshkrimi i Emirit Karlin tërhiqte Nga Bukuria e tij, shikimin s,e hiqte.
Mbreti i Evropës ,Karli i Madh Për shkrim e këndim fort kishte madh.
Nga Emiri El-Mumun, Harun Al-Rashid Nga dituria e tij fort ishte mahnit Mbi dzyzet vjet Karli kishte kalu Kur ABC Karli filloi me mësue.
Kur Harun AL-Rashid sahatin i dërgoi Karli i Madh priftërinjtë grumbulloi. Dhuratën e Emirit kur e pane Nga vilania e injorancës për tokë ranë. Atë vepër madhështore nuk e besuan Për djall e morën ashtu menduan.
Harun Al-Rashid Emiru El Muminin Mësoi mbretin e Evropës si mësuesi fëmijn. Themelet e injorancës filluan m,u dridh Arsye e dije fillun t,zan fill.
Periudha e Bagdadit dhe Andaluzisë Rugën e zhvillimit i shtruan njerëzisë. Roli i diellit asht dritë me ba Ia dijnë, a s,ja dijnë rendësi nuk ka Ku asht islami, o lum zotnia Për te ka e do të ketë nevojë njerëzia*
Burhan Fili Charlston West Virginia shtator 2007
Jetumu ezzaman

SHTETI IZRAELIT ESHTË KUNDER PAVARËSISË SE KOSOVES



Megjithëse tashmë çështja e Pavarësisë së Kosovës po bëhet një fakt i kryer, qeveria serbe po bën përpjekje maksimale për të gjetur një mbështetje ndërkombëtare për të mbajtur në kufijt e saj shtetëror Kosovën e banuar me shumicë absolute shqiptare. Kreu i diplomacies serbe, Vuk Jeremië, bëri një vizitë të shpejtë në Izrael, kur beteja për fatin e ardhshëm të Kosovës po i afrohet finishit të zgjidhjes së saj. Në një takim me studentët e Universitetit më të madh në Tel-Aviv, Vuk Jeremiç deklaroi se për serbët Kosova është Jeruzalemi i Serbisë duke vendosur kështu një vijë paralele me shtetin Izraelit në mohimin e të drejtave për të jetuar në atdheun e vet ato që janë trashigimtarët e vërtetë të tij. Kryediplomati serb nuk doli pa një "dhoratë" nga shteti Izraelit i cili e garantoj Serbinë se shteti hebrej nuk do ta njohe pavarësinë e Kosovës, duke nenkuptuar se për hebrejtë e drejta për të qenë i lire në token tënde është e ndaluar. E vërteta është se hebrejtë janë ata që ka pushtuar Palestinën duke detyruar miliona palestinezë që të jetojnë në kampe jashtë Atdheut të tyre dhe njëkohësisht masakrojnë dhe vrasin ato palestinezë që kanë mbetur në

Palestinë me synimin e largët për t'i dëbuar edhe ato nga toka ku kanë lënë dhe janë rritur. Nuk dime në se mediat shqiptare kanë folur për vizitën e Jeremiçit në Izrael dhe për goditjen që hebrejtë i dhanë çështjes së Pavarësisë së Kosovës në këtë momente kur po vendoset fati i së ardhmes së saj.

Qëndrimi i ashpër dhe i pamëshirshëm i shtetit hebrej ndaj kosovarve paraqet rrezik shumë të madh për çështjen e pavarësisë së Kosovës, sepse lobi hebrej sot dominon fatet e të gjithë botës, kur kemi parasysh se ato dominojnë mediat dhe financat

botërore. Mendojmë se shqiptarët duhet të njohin të vërtetën për mardhënjet e vërteta në mes të shqiptarve dhe hebrejve dhe të heqin dorë nga spekulimet e rrezikshme që bëhen për gjoja miqësinë e madhe në mes të dy popujve. Këtë detyrë e kanë ato analistët dhe historianët që flasin për strehimin e mbrojtjen që shqiptarët u bënë hebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke harruar të theksojnë se gjermanët në Shqipëri nuk i kanë përndjekur hebrejtë, sepse gjermanët nuk e njihnin vehten pushtues në Shqipëri dhe si të tillë ato nuk kishin të drejtë të persekutonin qytetarët shqiptarë, në një kohë që në Kosovën e pushtuar ato i arrestuan të gjithë hebrejtë, sepse Jugosllavia ishte e pushtuar.

Kjo e vërtetë u duhet thenë shqiptarëve që ato të njohin miqtë e vërtetë dhe të njohin ato që ishin kundër bombardimeve të NATOS në Kosovë dhe që sot janë edhe kundër pavarësisë së Kosovës. Loja me miqësinë tradicionale të shqiptarve me hebrejtë tashmë duhet të marrë fund dhe me këtë rast duhet të dalin jashtë loje edhe ato historianë dhe analistë të cilëve shqiptarët nuk u besojnë më, sepse tashmë shqiptarët e kanë marrë vesh se "Ku e kanë lidhur kalin" këto analistë dhe historianë'

Selim Gokaj
Shkodër me 2 janar 2008

NE PAKISTAN VRITET BENAZIR BUTO



Mediat në të gjithë botën dhanë lajmin e rendë se në Republikën Islamike të Pakistanit është vrarë ish-kryministja e këtij vendi, Benazir Buto e cila sapo ishte kthyer

nga një azil politik të cilin ia pat imponuar presidenti aktual i Pakistanit, Pervez Musharraf. E vendosur në ballë të një opozite, që synonte të fitonte zgjedhjet e janarit që do të zhvilloheshin në Pakistan, e ndjera Buto filloi një fushatë të ashpër sidomos kundër shkollave muslimane, duke i quajtur ato ambjente që nxerrin vrasës në terren dhe furnizojnë grupet radikale me kamikaze. Në vazhdim të kësaj linje, ajo ishte betuar se në emër të demokracisë perëndimore do të shpallte një luftë të ashpër ndaj islamikëve në Pakistan. Zonja Buto mendonte të ndante

pushtetin me presidentin Musharraf, duke synuar kështu që të zvoglonin vlerat islame në këtë republikë islamike të cilën e ka përfshirë dhuna. Por, duket se Musharraf nuk donte të ndante pushtetin me të ndjerën Benazir Buto e cila u vendos në mes të këtyre dy zjarreve dhe fati i saj tashmë ishte përcaktua përfundimisht. E ndodhur në mes të këtyre dy zjarreve ajo nuk mund të jetonte më. Atentati dhe shpërthimi kamikaz kundër saj i dhanë goditje të ashpër mundësive që duhet të ketë çdo force politike për të konkuruar në zgjedhjet për pushtet në çdo vend të botës.

Por, fundi tragjik i Benazir Butos është një mësim për të gjithë politikanët që të njohin situatën dhe të jenë të matur në fushata elektorale, sepse misionet e rrezikshme, që ata marrin përsipër që të realizojnë, mund t'u kushtojnë jetën, sidomos kur këto misione drejtohen kundër interesave të grupeve të fuqishme të cilat mund të jenë islame ose shtetërore

Vëshguesi

INTELEKTUALI DHE SHOQËRIA NJERËZORE

Në jeten tonë të përditshme përdoret shpesh fjala “intelektual”, sidomos në ditët e sotme. Duke diskutuar në rrethet shoqërore, apo në biseda me miqë dashamirë, abuzohet shumë me këtë fjalë, duke cilësuar në mënyrën më të padrejtë “intelektual” një shok, një mik, apo thjeshtë një njeri që nuk e meriton këtë cilësim. Sipas meje “intelektual” mund të quhet një studiues që ka përgatitur të veçantë në një, ose shumë fusha të shkencës, të teknikës, të kulturës dhe një formim të gjërë arsimor, i cili merret kryesisht me punë mendore, pra që është i aftë të merret me krijimtari në fushën e artit dhe letërsisë, apo me studime në fushat e shkencave shoqërore apo natyrore.

Intelektuali duhet të jetë në gjendje të deduktojë në problemet e jetës së përditshme apo në shkenca si dhe të ketë aftësi për të bërë analiza në fusha të ndryshme të artit, letërsisë, shkencës dhe të jetës së përditshme.

Intelektuali duhet të reflektojë thellë në botën e tij të brendshme si edhe në universin që e rrethon. Njeriu vjen në këtë jetë pa dëshirën e tij dhe largohet nga ekzistenca, përsëri pa dëshirën e tij. Njeriu gjendet i vetëm në këtë univers pa ditur asgjë nga bota që e rrethon. I ndodhur në këtë pozicion ai kërkon të dij çdo gjë në këtë botë, rreth mistereve dhe enigmave të kësaj gjithësie. Ai përpiqet të reflektojë sa më thellë, pasi është e vetmja qenie më arsye, të cilën krijuesi i Gjithësisë e veçoi nga të gjitha krijesat tjera, duke e përsosur me sistemin e arsytimit dhe të reflektimit të thellë në arsyen e krijimit të kësaj bote. Duke menduar e reflektuar në këtë pikë më kujtohet një sentencë e Ajnshtajnit : “.....Secili nga ne është në këtë jetë i përkohshëm; se me çfarë qëllimi, nuk e dimë, megjithëse nganjëherë na duket sikur e ndjejmë.....”

Njeriu gjendet përballë Universit, që në brendësinë e tij përfshihet një mister që ai nuk do të arrijë ta zbulojë kurrë. Gjëja më e bukur në brendësi të shpirtit të njeriut është përjetimi i këtij misteri. Intelektuali jeton me këtë ndjenjë themelore në shpirt, për të gjeneruar ne vazhdimësi të jetës me krijimtarinë, si formë të reflektimit të thellë shpirtëror dhe me zbulime të reja shkencore.

Intelektuali duhet të jetë gjithnjë në kërkim, në çdo çast, ditën apo naten, në veprimtarinë e përditshme, apo në meditimet e thella në orët e vona të natës. Truri i intelektualit nuk duhet të pushojë kurrë së punuari, së kërkuari, së hulumtuari. Ai duhet gjithnjë të meditojë për misteret e kësaj bote, për bashkëveprimet njerëzore me mjediset natyrore ku ai jeton dhe reflekton këtë harmoni që ka krijuar Zoti i Gjithësisë.

Intelektuali duhet të jetë një besimtar i mirë, pasi gjithë ky univers është i ndërtuar mbi bazen e një rendi, e një rregulli, mbi ligje e ligjësi të përpikta. Përkrah këto përsosmëri përben krijimtarinë e Krijuesit të Gjithësisë. Përsëri në lidhje me këtë fakt po i referohem Ajnshtajnit, shkencëtarit më të madh të të gjitha kohërave : “.....Njohja e ekzistencës së diçkaje, pa qenë e mundur të futemi në brendësinë e saj, e manifestimit të arsyes më të thellë dhe bukurisë më vezulluese, të cilat arsyeja jonë mund t'i kapë vetëm në format më të thjeshta, është kjo njohuri dhe ky emocion që përbëjnë qëndrimin e vërtetë besimtar; në këtë këndvështrim dhe vetëm në këtë, unë jam një njeri shumë besimtar.....”

Intelektuali duhet të karakterizohet nga një karakter i fortë dhe i vendosur për t'i çuar punët deri në fund. Ai duhet të ndertojë në mendjen e tij projekte që përputhen me synimet që i ka venë vetës për të arritur dhe pasi i ka ndërtuar këto projekte si koncepte, si ide në trurin e tij, atëherë duhet të kalojë menjëherë në zbatimin praktik të këtyre projekteve për t'i finalizuar këto në rezultate konkrete.

Në marrëdhëniet me njerëzit, intelektualit duhet të jetë i thjeshtë, sepse thjeshtësia paraqet bukurinë, respekt njerëzor. Ai duhet të jetë i komunikueshëm në shoqëri, i dashur, me moral të lartë, i kulturuar, sepse të gjitha këto paraqesin virtyte njerëzore. Virtyti e afron njeriun me veti hyjnore, pra në personin e tij duket dora e Krijuesit të Gjithësisë.

Intelektuali duhet të ketë atelien e tij, vendin ku ai mediton dhe krijon, ku kryen studime e hulumtime gjatë gjithë jetës. Unë nuk mund ta mendoj një intelektual, i cili nuk posedon një bibliotekë të tijën, sado e vogël apo e thjeshtë të jetë ajo. Ai duhet të ketë në këtë domë-studio edhe një kompjuter, përveç bibliotekës, i cili do t'i vijë në ndihmë qoftë për informacion që mund të marrë nëpërmjet internetit, qoftë duke hedhur në monitor meditimet dhe krijimtarinë e tij në momente krijimi apo studimi.

Në çdo moment njeriu ruan në memorien e tij njohuritë dhe eksperiencën e brezave që iken, përfiton njohuri të reja gjatë jetës së tij në shkollë e auditore universitare, apo në institucione të ndryshme dhe këto njohuri i përcjell tek brezat e rinj. Në këtë mënyrë intelektualit është bartës i kësaj dija në kohë dhe hapsirë. Pra intelektualit jeton jo vetëm për vete por edhe për të tjerët, është pjesë dhe nevojë e shoqërisë njerëzore. Ai duhet të ketë më shumë detyra ndaj shoqërisë njerëzore dhe më pak të drejta, duke nënkuptuar se ai duhet t'i japi shoqërisë më shumë se sa të marrë prej saj. Në këtë kuptim intelektualit është më shumë prodhues për shoqërinë njerëzore se sa konsumator i saj. Efektiviteti i punës së tij duhet të jetë i dukshëm dhe i prekshëm nga shoqëria. Ai duhet të shërbejë si shembull më pozitiv, si pikë referimi për brezat e rinj për të influencuar në rritjen e numrit të intelektualëve të rinj.

Intelektuali duhet të jetë gjithmonë në kërkim të së drejtës, të së vërtetës. Ai duhet të karakterizohet nga ndershmëria në jetë e shoqëri, në punën e tij. Shpirti i tij duhet të jetë në luftë të papajtuashme me padrejtësitë, me korrupsionin, në mbigjimin ose në nënvleftësimin e vlerave njerëzore. Ai duhet t'i vlerësojë njerëzit që e rrethojnë, t'i respektojnë ata, t'u dëgjojnë fjalën e

tyre dhe të marrë çdo vlerë të tyre duke i falënderuar për kontributin njerëzor. Intelektuali në një rreth intelektualësh apo njerëzish të thjeshtë duhet të dëgjojë shumë dhe të flasi sa më pak sepse kështu ai rritë vlerat e tij. Biseda e një intelektualit duhet të gjenerojë ose krijimtari në fushën e artit e të letërsisë ose një informacion shkencor që t'i shërbejë sa më mirë shoqërisë, e cila e dëgjon me kënaqësi atë.

Fjala e intelektualit duhet të dali nga thellësitë e shpirtit të tij dhe të ngjitet mirë në shpirtin e dëgjuesve, duke e bërë pjesë organike të qenies së tyre. Ajo duhet të peshojë rëndë aty ku bie dhe të qëndrojë për një kohë sa më të gjatë në jetën dhe shpirtin e dëgjuesve. Fjala e tij duhet të shërbejë si një shkëndijë, si një dritë që rrezaton shpirtërat njerëzorë. Ajo duhet të futet deri në skutat më të errëta të shpirtit njerëzor për t'i sjellë atij ndriçim dhe frymëzim në punën krijuese.

Me qenë se njeriu ka nevojë që të dijë sa më shumë rreth mjedisit në të cilin jeton, Zoti e ka pajisë atë me organe shqisore marrëse dhe dhënëse si sytë, veshët, hunda, të cilat i shërbejnë për të marrë informacion dhe vetëm goja është organ për dhëjen e informacionit. Në këtë kuptim njeriu duhet dhe ka nevojë të dëgjojë sa më shumë dhe të flasë sa më pak. Njeriun e shtynë kureshtja për të ditur sa më shumë rreth këtij Universi. Qëndrojmë para një luleje dhe mrekullohemi me konstruktin e ndërtimit të saj. Kurora e saj me ngjyra dhe aromë për të tërhequr insektet, thekët, si organe seksuale mashkullore në periferi dhe pistili si organ seksual femëror në qendër, që kundrohet aq ëmbëlsisht nga organi seksual mashkullor, na bëjnë të mendojmë për këtë harmoni që ka krijuar Zoti i Gjithësisë. Ai ka harmonizuar e përsosur çdo krijesë të tij.

Intelektuali është gjithmonë cilësi ndërsa shoqëria njerëzore është sasi. Po ta marrim në këtë kuptim ndryshimet sasiore kanë sjellë kurdoherë në ndryshime cilësore. Kështu shoqëria njerëzore, në procesin e zhvillimit të saj ka prodhuar intelektualë, të cilët kanë shërbyer si promotorë të zhvillimit të saj. Intelektuali, në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale, është ajka e shoqërisë njerëzore dhe si e tillë ajo ka dalë gjithmonë në krye të kësaj shoqërie, duke i ndriçuar rrugën, duke i treguar progresin.

Intelektuali është në gjendje të shohë me sytë e imagjinatës në thellësi të mistereve të botës që na rrethon. Ai futet deri tek grimcat më të vogla materiale që janë atomet, të cilat ai shkencërisht i sheh, i ndanë dhe i analizon. Ai është në gjendje të dallojë energjinë potenciale dhe kinetike të atomeve, e cila ruhet përjetësisht nga Krijuesi.

Njeriu vjen në këtë ekzistencë por nuk e di se si u projektua dhe se si u muar vendimi.... por sa duket është një natë e qetë kur u krye akti seksual mes prindërve të tij. Ne atë çast u bë bashkimi i dy qelizave seksuale, vezës dhe spermatozoidit duke dhënë kështu një qelizë të quejtur zigotë dhe të pajisur me informacion gjenetik. Në këtë informacion, të quejtur AND, u projektua historia dhe të gjitha funksionet jetësore deri në fund të jetës, të këtij njeriu në miniaturë. Njeriu nuk mund dhe nuk duhet të bëhet mohues i këtij fakti, kur u muer vendimi për ardhjen e tij në jetë.

Intelektuali e njeh këtë informacion të quejtur ADN, i cili projekton ndërtimin e qelizave, indeve, organeve dhe gjithë organizmin e njeriut. Pra brenda kësaj ADN-je gjendet gjithë historia e jetës së njeriut, e cila u realizue me vullnetin e Krijuesit të Gjithësisë. Inteligjenca njerëzore nuk është në gjendje të realizojë një projekt të tillë, por është në gjendje të gjykojë se këtë e realizon vetëm Inteligjenca Absolute, pra Inteligjenca Hyjnore. Në qoftëse intelektualit nuk e kupton këtë fshehtësi të fuqisë Absolute, ai nuk mund të quhet intelektual. Njësimi i ndërtimit në parim i një atomi me ndërtimin e një qelize, e një planeti, e një sistemi diellor, e një galaktike dhe e gjithë Universit, të cilat në qendër ruajnë pjesët më të rëndësishme të tyre dhe në periferi kontrollojnë pjesët më pak të rëndësishme; tregojnë se ka një Projektues të Përgjithshëm, i cili drejton dhe kontrollon Universin.

Kur kemi provuar në laborator të sintetizojmë një molekul nga bashkimi i dy pjesëve hidrogjen me një pjesë oksigjen, kemi parë se çfarë energjie çlirohet në momentin e bashkimit të këtyre dy elementëve. Gjykoni se ç'energji është çliroar në sistemin diellor për të krijuar ujin dhe atmosferen e planetit tonë?! Nuk po futemi për të gjykuar më në thellësi në krijimin e sistemeve diellore, galaktikave etj. Mos i gjithë ky proces ishte një rastësi?! Vetëm një i pa ditur mund ta mendojë si rastësi. çdo gjë është drejtuar dhe organizuar nga ligje dhe ligjësi të krijuara nga Zoti i Gjithësisë. Po të mendojmë ndryshe do të gabojmë rëndë. Mendoni, përfytyroni dhe mediton thellë një Univers të tillë, një organizëm gjigand që duket sikur merr frymë, sikur e imagjinojmë dhe e shohim frymëmarrjen e tij. Ky organizëm gjigand është gjallë dhe në një harmoni të përsosur dëgjohet melodia e tij, kompozimi, që Zoti i Gjithësisë e përsosi si një ekuilibër të tillë. Ajo molekula e ADN-së në kromozomet e bërthamës së qelizës është mrekullia më e madhe që realizon mbi gjashtë miliardë njerëz të ndryshëm nga njeri-tjetri. A nuk mendojmë më thellë jobsimtërit?! Ai çelës që nuk e shohim me sy, pasi është një molekulë mikroskopike, është në gjendje të projektojë një sy, një vesh, një gojë, një dorë, një sistem të qarkullimit të gjakut, një funksion të sistemit nervor, një..... pafundësi. Në këtë kuptim mund të themi se njeriu po arriti të njohë vetveten, ai ka njohur Zotin e tij.

Intelektuali shikon me sytë e imagjinatës, ndjenë me ndjenjat e shpirtit se brenda kësaj Gjithësie ekziston një Rregullator që ve në lëvizje çdo gjë në ekzistencë, nga njësi më e vogël materiale, që është atomi, deri tek galaktikat. Gjatë medimitit në vetmi, intelektualit i inspirohet diçka e fshehtë që

vjen nga Zoti, i cili i tregon të Vërteten. Ai e ndjenë në shpirt këtë, Zemra me të rrahurat e saj e kupton se diku në një zonë të fshehtë, që njeriu nuk e shikon por e kupton, ekziston Ai që i jep shpirt gjithë këtij Universi.

Intelektuali, duke qenë pjellë e shoqërisë njerëzore dhe udhërrëfyese e saj, ai duhet të jetë në anën e lirisë, të të pambrojturve, të të diskriminuuarve, të të vegjëlve. Ai duhet të jetë në kërkim të së Vërtetës, të së Drejtës dhe si i tillë ai nuk duhet ta pushojë kurrë luftën për liri e drejtësi, kjo edhe sikur ta paguaj me çmimin më të lartë. Duke pasur parasysh se sot pushtetarët nuk po mbrojnë interesat e të varfërve, e të vegjëlve, më një fjalë interesat e qytetarëve të tyre, intelektualit është dhe duhet të jetë gjithmonë në opozitë me ata që e mbajnë pushtetin për interesat të veta. Po të shikojmë nga historia e zhvillimit të shoqërisë njerëzore do të kuptojmë se intelektualit pushtetin e tij e ushtron në një vepër artistike, në romane, në poema, në poezi, në vepra muzikore, në çdo aktivitet të tij.

Shpirti i intelektualit nuk duron asnjëherë padrejtësi, pabarazi, shtypje, përçmim, dhunë, grabitje etjere, që i bëhet shoqërisë nga ata që gjenden në majen e piramidës së shtetit. Shpirti i tij është nën një trysni. Ai është i brengosur, dhe duke e vuajtur këtë brengë fillon gërryerjen nga brenda në formën e një revolte. Pra intelektualit në çdo kohë është avokat mbrojtës i shoqërisë njerëzore. Të gjithë njerëzit para Zotit janë të barabartë, atëherë pse kjo shtresë e privilegjuar që ndodhet në pushtet sot e mohojnë këtë të drejtë Hyjnore?!

Varfëria më e madhe e njeriut është ajo mendore, është varfëria në dije. Dijen nuk ia privoi Zoti asnjë njeriu. Të gjithë e gëzojnë këtë të drejtë për t'u pajisë me te, por jo të gjithëve ju krijua mundësia për ta kërkuar dijen. çdo njeri është i pajisur nga Zoti me një dije fillestare që ruhet thellë në subkoshiençen e tij. Gjatë jetës kjo dije shtohet duke studiuar në fe, në shkenca natyrore e shoqërore. Intelektualit ju krijua kjo mundësi, falë edhe vullnetit e këmbënguljes së tij për t'u thelluar në dije. Intelektuali e ndihmon shoqërinë njerëzore duke e udhëzuar me veprat e tij, për ta kërkuar këtë të drejtë të mohuar nga pushtetarët. Gjithë jetën intelektualit është në kërkim të gjetjes së rrugëve për mbrojtjen e padrejtësive, në kërkim të gjetjes së rrugëve për rritjen e mirëqenies së qytetarëve, në kërkim të gjetjes së rrugëve për përmirësimin e jetës shpirtërore dhe shoqërore të shoqërisë, në kërkim të dijes.

Meqenëse Universi është i mbushur me mistere dhe enigma që njeriu nuk do të arrijë kurrë t'i kuptojë e t'i hulumtojë deri në fund, ai mbetet gjithmonë në kërkim të këtyre mistereve për të marrë sa më shumë njohuri mbi këtë univers që na rrethon. Më kot nuk thonte Lui Kervran, biolog francez, se njeriun është i pa ditur në këtë univers. Ai e shpreh këtë mosnjohje kështu : “Ne ecim mbi fakte dhe nuk i shikojmë sepse jemi qorra. Fakti na thërret : “Ja ku jam!” por ne nuk e dëgjojmë sepse jemi të shurdhër. çdo gjë ekziston në natyrë për njohja njerëzore është e pakët. “ Njohja e këtij universi është detyrë parësore e çdo intelektualit, duke mos përjashtuar në këtë të drejtë gjithë shoqërinë njerëzore.

Parimi i organizimit të qenieve të gjalla si edhe i të gjitha ngjarjeve e fenomeneve të natyrës dhe shoqërisë njerëzore është se : “Ajo çka ndodh në sipërfaqe rregullohet nga ajo që fshihet në thellësi.” Pra organet apo ngjarjet e dukshme, sundohen nga funksionet e padukshme. Është diçka në thellësi të fenomeneve dhe të bërthamave, të cilat “urdhërojnë” dhe “japin drejtimin” e veprimtarisë jetësore çdo pjesë të dukshme që ne e perceptojmë me organet e shqisave. Një natë me Hënë ne meditojmë mbi Universin, mbi Tokën, Hënë, Diellin, yjet, sistemet diellore, galaktikat dhe mahnitimi me organizimin, drejtimin, rregullin dhe rendin që ka vendosur në ekuilibër çdo gjë në Ekzistencë. çdo njeri, çdo intelektual menjëherë do të gjykojë se Rregullator i çdo fenomeni dhe ekuilibri që zhvillohet në univers është Ai që fshihet në thellësi, Krijuesi dhe Organizuesi i Universit, Zoti ynë. Është obligim i çdo intelektualit që, ato, të cilat i di, t'i përçojë deri tek njeriu më i thjeshtë i shoqërisë njerëzore.

Në librin “Prej dyshimit deri në besim” të doktor Mustafa Mahmud, filozof dhe dijetar egjiptian ka një thënie filozofike : “...Njeriu, me dashuri është krijuar, për dashuri është krijuar dhe për dashuri është denuar.....I Hyjnyar dhe i Lartësuar je Ti... Ti je Mëshirues dhe i Urtë. Ti na krijove !”

Po të reflektojmë thellë në këtë sentencë filozofike mund të gjykojmë se njeriu nuk erdhi mbi këtë tokë pa një qëllim. Ai erdhi me një mision të veçantë mbi këtë planet, si zvendësi i Zotit mbi tokë. Zoti i dha atributet e Tij që ta studiojë dhe ta ndryshojë botën në të cilën jeton, ta njohin Zotin e tij, ta falënderojë për dhuratën më të çmuar që i dha, jeten e tij, të ruaj paqen dhe qetësinë mbi planet duke shtuar dashurinë dhe respektin për Zotin e tij dhe për njeriun, krijesen më e përsosur në të gjitha krijesat e tjera. Dhe dashuria mes njeri-tjetrit tritet duke ruajtur e respektuar vlerat e njeri-tjetrit. çdo njeri në vetvete duhet të luftojë për heqjen e veseve, të mos i nënçmojë të tjerët, të mos i përbuzi, të heqë urrejtjen, ambicjen, egon e sëmurë, intrigen, e sa e sa vese të tjera të cilat janë të dëmshme për çdo njeri, për çdo intelektual. Po të zhvishemi nga këto të meta patjetër do të fitojmë veti hyjnore, duke e pasuruar shpirtin tonë. Respekti ndaj njeri-tjetrit është jo vetëm virtyt njerëzor, por edhe hynor, sepse një ditë ne të gjitha këto do t'i lëmë mbi këtë tokë : familjen, pasurinë, jetën tonë dhe do të marrim me vete vetëm veprën tonë, e mirë apo të keqe qoftë ajo. Atëherë le të marrim me vete sa më shumë vepra të mira, të cilat do të na shërbejnë në Gjykimin e Madh.

Nga Riza Spahija

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.
2- Piceri hallall
3- Fast Food hallall**

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bami-rës Islam), ju afro-n prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zy-rash
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale-sh
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobil-it: 0692523565

